



REPUBLIKA E KOSOVES-REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Pranuar / Dorezuar Priljena/Prodato Received/Delivery	26.04	2022	2	viti god year
Organ /Njesia Organ /Jednica Org /Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shitje Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity	
SKAMSHOK	2430/2022		1/5	



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.150/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës - Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Arben Mehmeti-kryetar, Ardita Haxhnikaj Demi dhe Jeton Koca -anëtarë, si dhe Sabile Avdyli-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtëses, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.150/2022 të datës 22.02.2022 të parashtruar nga ankuesi me adresë banimi kundër organit të punësimit Zyra e Kryeministrit, në çështjen juridike „masë disiplinore“, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datë 26.04.2022, mori këtë:

V E N D I M

- I. Refuzohet si e pa bazuar ankesa me numër A.nr.150/2022 e datës 22.02.2022, e parashtruar nga ankuesi
- II. Mbetet në fuqi Vërejtja e dytë e datës 27.01.2022 me nr.2759-2/2022 e shqiptuar nga Drejtori i Departamentit për të Drejtën e BE-së.

A r s y e t i m

Ankuesi i punësuar në pozitën “Zyrtar i Lartë ligjor ” sipas Akt emërimit të datës 17.06.2019 në Departamentin e të Drejtës në BE /Ministria e Integritimeve Europiane/ZKM në Zyrën e Kryeministrit, më datën 25.01.2022 ka parashtruar ankesë te Zëvendësuesi i Sekretarit të Përgjithshëm në Zyrën e Kryeministrit kundër sjelljes së Drejtorit të Departamentit për të Drejtat e BE-së. Me datën 27.01.2022 Drejtori i Departamentit për të Drejtat e BE-së. i shqipton vërejtje me numër protokoll 2752-2/2022.

Ankuesi i pakënaqur me vërejtjen e datës 27.01.2022 me numër protokoll 2752-2/2022 të shqiptuar nga Drejtori i Departamentit për të Drejtat e BE-së, më datë 22.02.2022 ka parashtruar ankesë me numër protokoll 906/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës me datën 25.02.2022 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë të ankuesit tek Zyra e Kryeministrit, ndërsa me datën 11.03.2022 Këshilli ka pranuar përgjigjen në ankesë nga organi i punësimit së bashku me provat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, me rastin e trajtimit të kësaj ankese dhe me qëllim të vendosjes meritorë ka administruar këto prova: Ankesa e ankueses e datës 22.02.2022 me numër protokolli 926/2022 e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; E-mail zyrtar i datës 25.01.2022; E-mail zyrtar i datës 26.11.2021; E-mail zyrtar i datës 25.11.2022; E-mail zyrtar i datës 26.01.2022; E-mail zyrtar i datës 27.01.2022; E-mail zyrtar i datës 26.01.2022; Vërejtje e dytë e datës 27.01.2022 me nr.2759-2/2021; Ligji Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë; Rregullore Nr.21/2020 për Procedurën e Vlerësimit të Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimeve Publike; Rregullore (QRK) Nr.11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publikë; E-mail i datës 26.01.2022 nga Zëvendësuesi i Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së; E-mail zyrtar i datës 26.11.2021; E-mail zyrtar i datës 25.11.2021; E-mail zyrtar i datës 25.01.2022; E-mail zyrtar i datës 26.01.2022 për Zëvendësuesin e Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së; E-mail zyrtar i datës 26.11.2021 për Zëvendësuesin e Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-s; E-mail zyrtar i datës 25.11.2021 për Drejtorin e Departamentit për të drejtën e BE-së; E-mail zyrtar i datës 25.11.2021 për Zëvendësuesin e Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-s; E-mail zyrtar i datës 25.11.2021 për ankuesin; E-mail zyrtar i datës 10.01.2022 për planin vjetor të trajnimeve; E-mail zyrtar datës 11.01.2022; E-mail zyrtar i datës 12.01.2022; E-mail zyrtar i datës 13.01.2022; E-mail zyrtar i datës 17.01.2022; E-mail zyrtar i datës 17.01.2022; E-mail zyrtar i datës 18.01.2022; E-mail zyrtar i datës 13.01.2022; E-mail zyrtar i datës i datës 08.12.2021 nga zyra e personelit-Informatë rreth vlerësimit të rezultateve në punë; E-mail zyrtar i datës 19.01.2022; E-mail zyrtar i datës 22.01.2022; E-mail zyrtar i datës 22.01.2022; E-mail zyrtar i datës 24.01.2022; E-mail zyrtar i datës 24.01.2022 për Menaxheren e Personelit; E-mail zyrtar i datës 24.01.2022 për ankuesin; E-mail zyrtar i datës 20.01.2022; E-mail zyrtar i datës 24.01.2022; E-mail zyrtar i datës i datës 19.01.2022; E-mail zyrtar i datës 19.01.2022-Procedim i kërkesës për qasje në dokumente zyrtare; E-mail zyrtar i datës 23.01.2022; E-mail zyrtar i datës i datës 24.01.2022 për Menaxheren e Personelit; E-mail zyrtar i datës 23.01.2022-njoftim; E-mail zyrtar i datës 25.01.2022; E-mail zyrtar i datës 26.01.2022 per ankuesin; E-mail zyrtar i datës 18.01.2022; E-mail zyrtar i datës 20.01.2022; E-mail zyrtar i datës 20.01.2022-regjistrimi për pjesëmarrje në trajnim; E-mail zyrtar i datës 31.12.2021; E-mail zyrtar i datës 24.01.2022; Përgjigje në ankesë nga organi i punësimit e datës 11.03.2022 me nr.protokolli 1307 /2022 bashkë me shkresat e lëndës; faqe 1/102; E-mail zyrtar i datës 27.01.2022; Vërejtje e dytë e datës 27.01.2022 me nr.2759-2/2021; Ligji Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë; Rregullore Nr.21/2020 për Procedurën e Vlerësimit të Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimeve Publike; Rregullore Nr.14/2020 për Transferimin e Nëpunësve Civil; E-mail zyrtar i datës 26.01.2022; E-mail zyrtar i datës 25.01.2022; E-mail zyrtar i datës 26.01.2022 për Sekretarin; E-mail zyrtar i datës 25.01.2022; E-mail zyrtar i datës 26.01.2022 për Sekretarin; E-mail zyrtar i datës 26.01.2022 për raportin vjetor të vijueshmërisë; E-mail zyrtar i datës 25.01.2022; E-mail zyrtar i datës 10.01.2022; E-mail zyrtar i datës 12.01.2022; E-mail zyrtar i datës 14.01.2022; E-mail zyrtar i datës 17.01.2022; E-mail zyrtar i datës 18.01.2022; E-mail zyrtar i datës 13.01.2022; E-mail zyrtar i datës 19.01.2022; E-mail zyrtar i datës 22.01.2022; E-mail zyrtar i datës 24.01.2022; E-mail zyrtar i datës 20.01.2022; E-mail zyrtar i datës 24.01.2022-vlerësimi për vitin 2021; E-mail zyrtar i datës 25.01.2022; E-mail

zyrtar i datës 13.01.2022; E-mail zyrtar i datës 20.01.2022-apikacioni për trajnime në IKAP; E-mail zyrtar i datës 24.01.2022 -kërkesa për pushim vjetor; E-mail zyrtar i datës 20.01.2022 për pushim mjekësor; E-mail zyrtar i datës 27.01.2022 për transfer dhe E-mail zyrtar i datës 26.01.2022 -ankesë dhe kërkesë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pasi ka shqyrtuar dhe analizuar shkresat e lëndës të parashtruara nga palët, konstatoi se ankesa e ankuesit, është e pabazuar *sepse*:

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave gjatë shqyrtimit të provave të lëndës ka konstatuar se ankuesi ka pasur vërejtje nga mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë me datën 26.11.2021, po ashtu, me datën 27.01.2022 prapë i ka shqiptuar vërejtje me arsyetimin se që nga vërejtja e parë ankue: nuk ka bërë asnjë veprim që të përmirësojë sjelljen e tij brenda zyrës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave gjatë shqyrtimit të provave të ankesës ka konstatuar se me autorizimin e datës 07.07.2021 me numër 1814 të Sekretarit të Përgjithshëm të Zyrës së Kryeministrit është angazhuar përkohësisht deri në ristrukturimit të ZKM-së dhe ish MIE në Zyrën për Çështjet e Kategorive të dala nga Lufta e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Me datën 15.10.2021 Drejtori i Departamentit për të Drejtën e BE-së ka kërkuar nga Sekretari i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit për shkak të kërkesave të shumta ligjore për shqyrtim të përputhshmërisë me acquis të BE-së.

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, pretendon se vërejtja e shqiptuar me datën 27.01.2022 nga mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë është në kundërshtim me dispozitat e Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, Rregulloren (QRK) Nr.11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publikë dhe Rregulloren (QRK) Nr.12/2020 për Orarin e Punës dhe Pushimet e Zyrtarëve Publikë dhe hakmarrje.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave konstaton se këto pretendime janë të paqëndrueshme sepse në bazë të provave që kemi dëshmojnë se ankuesi vazhdimisht në bazë të e-mailave që kemi në lëndë është i pakënaqur me Drejtorin e Departamentit për të drejtën e BE-së, në emailin e datës 25.01.2022 dërguar Sekretarit të Përgjithshëm të Zyrës së Kryeministrit në ankesën e parashtruar ndër të tjera thekson se " *nuk është profesionist dhe nuk ka aftësi menaxheriale*". Për këtë sigurisht është në dijeni se Vlerësimin për mos profesionalizëm dhe aftësi menaxheriale i'a bënë mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i Drejtorit të Departamentit për të Drejtën BE-së, pastaj në ankesën dërguar Sekretarit të Përgjithshëm të Zyrës së Kryeministrit ndër të tjera citon se ka sjellje abuzive dhe me presion ndaj zyrtarëve duke keqpërdorë autoritetin e tij ndaj zyrtarëve, Kolegji për këtë rast nuk posedon asnjë provë nga ankesa e ankuesit dhe poashtu nuk ka asnjë ankesë në këshill të adresuar nga ndonjë zyrtarë që i referohet ankuesi.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e ankesave ka konstatuar se Sekretari i Përgjithshëm ankesën e ankuesit përmes e-mailit zyrtar e ka përcjell tek Drejtorit të Departamentit për të Drejtën BE-së sepse i njëjti është mbikëqyrës i drejtpërdrejtë i pasi që të dytë janë ish nëpunës civil të Ministrisë për Integritet Evropian dhe deri në ristrukturimin e Zyrës së Kryeministrit. I njëjti pa u konsultua fare me mbikëqyrësin e tij ka kërkuar që të transferohet në Zyrën e Komisionerit për Gjuhët në kuadër të Zyrës së Kryeministrit. Me vendimin e datës 01.03.2022 me nr.383/2 të nxjerrë nga Sekretari i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit ankuesi është

transferuar përkohësisht në po të njëjtën pozitë në Zyrën e Komisionerit për Gjuhët në kuadër të Zyrës së Kryeministrit prej datës 01.03.2022 deri më datën 31.08.2022.

Pastaj ankuesi kërkon që vlerësimi i punës për vitin 2021 t'i bëhet nga Drejtori i Zyrës Ligjore të Kryeministrit duke anashkaluar mbikëqyrësin e tij të drejtpërdrejtë, e cila kërkesë është në kundërshtim me Ligjin Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë dhe Rregulloren Nr.21/2020 për procedurën e Vlerësimit të Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimeve Publike.

Pastaj ankuesi me datën 18.01.2022 ka njoftuar mbikëqyrësin se pas shfaqjes së disa simptomëve ka qenë në QKUK dhe ka bërë testin PCR por rezultati nuk më ka dalë ende, ka munguar në punë disa ditë dhe në provat që kemi nga organi i punësimit dhe nga ankuesi nuk posedojmë asnjë rezultat që ankuesi ka qenë i sëmurë nga Covid-19, pastaj përmes e-mailit ka kërkuar që ti hapet pushimi, ndërsa në bazë të provave zyrtarët që kanë dyshuar se janë infektuar nga Covid-19 menjëherë për rezultatin e kanë lajmëruar mbikëqyrësin për rezultatin, ndërsa ankuesi jo.

Kolegji duke marrë në konsideratë edhe pretendimet tjera të ankuesit, duke u bazuar në shkresat e lëndës dhe rrethanave të konfirmuara nga përmbajtja e ankesës, mbi bazë të arsyeve të ndryshme sipas pretendimit të tij por që për kolegjin nuk ishin relevante këto pretendime për faktin se nuk ndikojnë në vendimmarrje sa i përket objektit të kësaj ankesë për arsyet e specifikuara më lart, mbi këtë bazë Drejtori i Departamentit për të Drejtat e BE-së me rastin e shqiptimit të vërejtjes ka vepruar në pajtim me nenin 47 paragrafi 1 nënparagrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë dhe nenin 5 paragrafi 1 nënparagrafin 1.2 të Rregullores(QRK) Nr.11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publikë. Andaj Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka konstatuar se Drejtori i Departamentit për të Drejtat e BE-së me rastin e shqiptimit të vërejtjes për ankuesin ka vepruar në përputhje me legjislacionin në fuqi të shërbimit civil.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesës, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda, A.nr.150/2022, datë 26.04.2022

Sabile AVDYLI

Sabile Avdyli
Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional

Arben MEHMETI

Kryetar i Kolegjit



Vendimi i dërgohet:

- ❖ *Ankuesit*
- ❖ *Sekretarit të Përgjithshëm në Zyrën e Kryeministrit;*
- ❖ *Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Zyrën e Kryeministrit dhe*
- ❖ *Arkivat të KPMSHCK-së*

